



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:018773

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06357252

C-IV-14-7013

Parashtruesi i kërkesës

M I nga fshati K, Viti

kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH –NBI “Agromorava” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 28 tetor 2024 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Kërkesa për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit aprovohet si e bazuar.**
- 2. Shfuqizohet Aktvendimi i Autoritetit të likuidimit GJI035-0233 datë 1 tetor 2014.**
- 3. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit M I që në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 1,200.00 Euro.**
- 4. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 12 nëntor 2014, ankuesi pranë DHPGJS, parashtror kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI035-0233 datë 1 tetor 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin për shkak të ndërprerjes së parakohshme të punës, në shumë prej 1,200.00 (një dy zero zero) Euro, ndaj NSH – NBI “Agromorava” (në likuidim).

Ankuesi pohon se ishte i punësuar pranë NSH gjer në momentin e privatizimit të saj. Ankuesi, me anë kësaj kërkesë, i referohet disa provave të cilat nuk i ka parashtruar.

Ankuesi në vijim pohon se në afatin e caktuar e të rregullt ka parashtruar kërkesën e tij mbi kompensimin e pagave të papaguara, dhe konsideron se pasi që marrëdhënia e punës i është

ndërprerë nga ana e Agjencisë në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit të punës në Kosovë i takon e drejta në kompensim.

Nga të gjitha arsyet i propozon gjykatës që kërkesa e tij mbi pagat të aprovohet dhe ti kompensohet shuma e kërkuar në lartësi pre 1,200.00 (një dy zero zero) Euro.

Me 16 korrik 2024, gjykata lëshoj një urdhër me anë të të cilit ankuesit ju kërkuar që të parashtroj kopjen e Vendimit të AL ndaj të cilit është ushtruar kërkesa për rishikim-ankesa.

Ankuesi ka përmbushur urdhrin.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 26 gusht 2024 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankuesit ka vendosur në pajtim me dispozitat ligjore. AKP tutje se kërkesa për rishikim nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe Ligjit për procedurën kontestimore - LPK. AKP përfundimisht pohon se kërkesa për rishikim-ankesa është e pabazuar respektivisht e parashkruar e në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe Ligjit për punën e bashkuar – LPB pasi që ankuesi nuk ka kërkuar të drejtën mbi pagat në afatin 3 (tre) vjeçar. Nga gjitha arsyet propozoj që kërkesa e ankuesit për rishikim të hedhet si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL, dhe
- Kopja e Vendimit për emërimin e AL.

Përgjigja e AKP ju dorëzua ankuesit me 18 shtator 2024.

Ankuesi nuk ka parashtruar përgjigje.

Gjykata gjatë procedurës së shqyrtimit dhe verifikimit, gjeti Listën e punëtorëve të kësaj NSH të cilët kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të hyrave të 20% nga privatizimi i NSH, listë kjo e publikuar nga ana e AKP. Sipas kësaj liste shihet se ankuesi ishte i përfshirë në listë dhe me përvojë pune prej 27 vitesh 4 muaj e 8 ditë.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesa për rishikim konsiderohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit (ligji nr. 06/L-086) për DHPGJS, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata, në rastin konkret, konsideron se lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit

për AKP-në .

Nga dispozitat e lartë cekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse:

- a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë pohimet e ankuesit dëshmojnë se ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

LISTA E PUNËTORËVE e publikuar nga AKP, argumentojnë pohimet e ankuesit se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i NSH-së gjer me datën e privatizimit të saj, respektivisht 25 nëntor 2005.

AKP, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohojë drejta në kompensimin e pagave. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contestation*) e për më tepër provat e listuara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. AKP për më tepër të drejtën në kompensim të ankuesit, si në Vendimin e saj ashtu edhe me përgjigjen e saj, e bazon në parashkrimin e kërkesës.

Gjykata gjeti se në përputhje me Ligjin e Punës (Ligji nr. 03/L-212), ligj ky në fuqi nga data 15 dhjetor 2010, nenit 76 paragrafi 7 pika 7.4, në kuptim të kompensimit i takojnë 6 (gjashtë) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 deri në 29 vite shërbimi).

Në rastin konkret me rastin e vendosjes, mbi shumën e kërkesës prej 1,200.00 (një dy zero zero) Euro, gjykata në kuptim të nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 (*vendosja brenda kufijve të kërkesave*) të Ligjit për procedurën kontestimore –LPK, vendosi si në pikën 3 të dispozitiv të aktgjykimit.

Nga gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesi ka arritur që të dëshmoj të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Çështja e parashkrimit të kërkesave të ankuesit

Gjykata konsideron se ankuesi ka arritur ta dëshmoj, me anë të LISTËS SË PUNËTORËVE se ishte punëtor legjitim i NSH gjer me datën 25 nëntor 2005 andaj pavarësisht pohimeve të AKP, është dëshmuar se ankuesi ishte punëtor i NSH gjer me datën e fillimit privatizimit, dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë me veprimin e Agjencisë (neni 40 i Shtojcës së Ligjit për AKP).

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB (gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Tutje lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikës 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.

Sipas nenit 370, të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (gazeta zyrtare RSFJ nr. 29/78 me plotësime dhe ndryshime 39/85, 45/89, 31/93), thuhet:

“Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.

Dispozitat e lartë cekura të LMD, ishin në aplikim në kohën e marrjes së njoftimit.

Dispozita identike parashihen edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 347 dhe 351), dispozita ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Rregullat për parashkrimin, në rastin konkret, nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankuesit, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Tutje duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventual, afatet e parashtrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartë cekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të Likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përbushjen e obligimeve kreditore, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (*lex specialis*).

Asnjë punëtor apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesi nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar